

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Këshilli Prokurorial i Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	250-25-3538-5-2-1
------------------	-------------------

Sa i përket tenderit për **Renovimi i Oborrit dhe Hapësirave të mbrendshme në PTH Ferizaj**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SMART ENG GROUP SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Brigada 123, p.n.

(Adresa)

Suharekë

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349220599

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Astrit Tahiri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

eng.smart2021@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.07.2025

(Data e parashtrimt të kërkesës)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

- Njoftimi për kontrate – 25.04.2025
- Hapja e ofertave – 19.05.2025
- Njoftimi mbi vendimin – 11.06.2025
- Kërkesa për Ri shqyrtim 16.06.2025
- Vendimi i AK-se – Aprovimi i pjeseshëm 18.06.2025
- Njoftimi mbi vendimin e AK-se – Anulimi i procedurës 20.06.2025
- Kërkesa për ri shqyrtim 21.06.2025
- Vendimi i AK-se – refuzimi i kërkesës – 23.06.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

Hapja e ofertave – 19.05.2025

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐

Jo ☐

Operatori Ekonomik ankues – lideri i grupit, “Smart En Group” shpk, ndaj kesaje procedure te prokurimit, me datën 20.06.2025, bazuar ne dispozitat e nenitn108/A, te LPP-se, ka parashtruar kerkese për ri shqyrtim te vendmit, janë prezantu fakte për shkelje ligjore dhe shkelje te parimeve te prokurimit publik.

Pavaresisht kesaje, zyra e prokurimit dhe zyrtaret përgjegjës te saje me vendmin e datës 23.06.2025, kane refuzuar kerkesen dhe lane lejuar te procedohet tutje pavaresisht shkeljeve ligjore.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr 04/L-042, i amandamentuar.

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Rregullorja me nr 001/2022, për Prokurim Publik

- Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
- Neni 43 Ndërprerja e procedurave të prokurimit
- Neni 97 Shkeljet e rënda

Udhëzuesi për prokurim publik

- Neni 10 – sqarimi i tenderit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Autoriteti Kontraktues – Këshilli Prokurorial i Kosovës – zyra e Prokurimit për këtë procedure të prokurimit, ka konsumuar shkelje ligjore që nga publikimi i procedurës në secilën fazë të sajë, si rrjedhojë fillimisht kishte propozuar për dheninë e kontratës kompani të pa përgjegjeshme e cila jo që nuk i kishte plotësuar kërkesat kualifikuese por e njëjta nuk kishte ofruar çmime fare në pozicione të caktuara, si rrjedhojë komisioni vlerësues, as që e kishte vlerësuar te njëjten ofertë por direkt e ka rekomanduar pavarësisht faktit, se te njëjtë kanë nënshkruar deklarata nën betim dhe kanë pranuar përgjegjësinë edhe civile edhe penale, për vlerësim real dhe ligjor në njërin anë dhe në anën tjetër tentohet të eliminohet kompania jone me arsyetime absurde dhe i cili nuk korrespondon as me gjendjen faktike dhe as me bazë ligjore.

Te gjitha këto shkelje dhe abuzim me prokurim publik e kemi pasqyrtuar me kërkesë për ri shqyrtim por AK – Zyra e Prokurimit as që ka marrë mundin të trajtoj pretendimet tona ankimore, andaj në kuptim të nenit 109, paraqesim kundër argumentet tona:

Pretendimet ankimore:

1. Pas publikimit të vendimit fillestar, abuzues dhe rekomandimin e kompanisë e cila në këtë procedure të prokurimit është favorizuar skajshëm nga AK- KPK, por që ishte e pamundur të lidhet kontratë me të, AK perseri pretendon të eliminoni ofertën tonë me arsyetim të njëjtë si në vendimin fillestar.

Në leter standarde të datës 20.06.2025, ndaj ofertës sonë perseri është potencuar se na mungon kamioni me vinc me aftësi mbajtëse në minimumin 10 metra lartësi të ngritjes së peshave, ju keni ofruar kamion kiper me kran i cili nuk është sipas kërkesës sonë kamion me vinc !

Ky arsyetim i eliminimit të kompanisë sonë është i qëllimshëm për të eliminuar grupin tonë të OE-ve, si rrjedhojë e kësajë AK – KPK zyrtaret përgjegjës dhe komisioni vlerësues i ofertave në këtë procedure të prokurimit ka futur në filtra vetëm ofertën tonë dhe asnjërin nga ofertat tjera, ani pse zyra e prokurimit në KPK, do duhej të ishte shembull për pa anësi, zbatim të ligjit për prokurim dhe akteve tjera. Favorizimi, perkateishti diskriminimi në këtë institucion është shqetësues dhe ne si Grup i OE-ve disponojmë me prova konkrete për tentativa të mashtrimit në prokurim publik dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare, ku pavarësisht kostos ne do të administrojme të gjitha provat dhe do të deponojmë në instancën perkatese.

Termet: “Kamion me vinc” dhe “Kamion me Kran”, përdoren për të njëjten makineri dhe nuk ka kurrefare dallimi. Dallimi i vetëm është përvetësimi i parasë publike i mbetur

ne tentative, ku tani me ne si kompani e kemi parandaluar një gje te tille, por perseri ju si AK-KPK, zyrtaret përgjegjës te prokurimi, nuk jeni shmangur nga përgjegjësia penale.


Madje vet AK – KPK, ne procedura tjera pavaresisht termi, vinq apo kran, me kompani tjera dhe për procedura tjera ka lidhur kontrata dhe këtë qeshtje nuk e ka raportuar ne leter standarde ndaj kompanive tjera. Kjo është baze për keqperdorim, baze për raportim ne instanca përgjegjese, prova te cilat janë publike ne platformen e prokurimi.

Me nenin 59.1, te LPP-se kjarte percaktohet se përgjegjësia e secilit anetare te komisionit vleresues është personale dhe për qeshtje te njëjtë prova ekzistojne edhe deklaratat nen betim te secilit anetare.

Ne oferte kemi prezantuar kamionin me paisje te kerkuar dhe me pershkrim kran dhe kjo qeshtje nuk ka te beje me pa përgjegjësi te kompanis sonë ka te beje me pershkrim ne librez te qaskullimit rrugore.

Pershkrimi vinc dhe kran është i ndryshem por funksioni dhe roli është i njëjtë dhe AK – KPK, permes zyrtareve përgjegjës ka kerkuar sqarim shtese dhe ne si kompani kemi ofruar shpjegim konkret për këtë qeshtje, por pavaresisht kesaje perseri tentohet te eliminohet kompania jone.

Shqarim: Po ju prezentojmë dy kamiona te njejtë ku njërit i shenon Kamion me kran dhe tjetrit kamion me vinq. Pas konsultave me ekspert te speticionit dhe doganjerët ata thanë janë te njejta por vetem nvaret prej shpeticierit qysh i emron pasi te dy fjalet jane fjal te huaja si (vinq – fjal turke, ndërsa kran – fjale gjermane).







Ju si autoritet

Prove: kërkesa për sqarim dhe sqarimi i bashkangjitur ne plateforme.

Autoriteti kontraktues si ne vlerësim fillestare te ofertave po ashtu edhe ne ri vlerësim ka qellim te caktuar eliminimin e kompanis sonë kunderligjeshem pavaresisht cmimit, pafaresisht faktit se vinci dhe krani kane kuptim te njëjtë oferta jone eliminohet ndërsa oferta e OE pjesemarres ne këtë procedure prokurimit propozohet për dhenien e kontratës ani pse nuk ka dhënë çmime fare ne paramase dhe paralogari, ani pse nuk i ka plotesuar kërkesat e kapaciteitit tekonk dhe profesional, ani pse ligji për prokurim publik, obligon komisionin qe te beje ekzaminim, krahasim dhe vlerësim te ofertave.

KPK dhe anëtarët e sajë me shkresë te veqante do te njoftohen lidhur me shkeljet ligjore ne këtë procedure te prokurimit.

2. Ne kërkesen për ri shqyrtim te datës 20.06.2025, ne si kompani i kemi paraqitur pretendimet tona ankimore se bashku me prova, ndërsa AK – KPK, zyrtarët pergjegjers te sajë me vendmin e datës 23.06.2025, për refuzimin e kërkeses nuk e kane trajtuar asnjërin nga pretendmjet tona ankimore dhe me këtë veprim kane shkelur edhe nenin 108/A te LPP-se, paragrafi 8 dhe 9 ku kjarë percaktohet se AK – mund te refuzoi një kërkesë për ri shqyrtim kur i ka trajtuar te gjitha pretendmjet ankimroe dhe kur ka dhënë sqarim kidhur me atë qe është kerkuar nga parashtruesi i kërkeses për ri shqyrtim.

Ne vendmin e datës 20.06.2025 AK – KPK, potencohet se: *...U vertetua se AK me te drejte dhe konform LPP-se ka bere vlerësimin e aktivitetit te ptokutimi pasi qe ka anlizë dhe vleresume kujdes te shtuar te gjitha pretendmjet ankimore...*

Gjendja faktike, ofertat dhe dokumentet tjera tregojne për te kundërtën e kesaje, asnjëri nga pretendimet tona nuk është trajtuar dhe nuk është respektu asnjëra nga dispozitat ligjore ne fuqi.

Këto prova, këto dëshmi tejkalojne dyshimin e bazuar mire ndaj secilit zyrtar te inkriminuar ku ne si operator ekonomik se bashku me këtë kerkese lenden do ta deponojme ne Prokurorine e Shtetit.

Me nenin 62, te LPP-se lidhur me nenin 43, te Rregullores me nr 001/2022, percaktohet kure AK mund te nderpres proceduren e propkurimit:

Neni 62, par 1 dhe 2 te LPP-se percakotjne:

Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Asnjëra nga dispozitat ligjore te pershkruara me sipër nuk janë konsumuar për ndërprerje dhe anulim te procedurës se prokurimit.

Madje me nenin 97, te Rregullores për prokurim publik, anulimi i aktiviteitit te prokurimit me këto arsye konsiderohet si shkelje e rende e ligjit:

Neni 97 - Shkeljet e rënda

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

- b. Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;
- d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të percaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë...,rajtim jo të barabart të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit...
- k. Anulimi i aktiviteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik

Te gjitha këto shkelje janë konsumuar dhe jo vetëm, madje për keso qeshtjesht tipike dhe identike OSHP, përmes shume vendmiesh ka ndërmarrë veprime tjera ligjore ka shqiptuar gjobe, ka inicuar procedure ne KRPP, për anulim te certifikates dhe si prove mund ti referoheni

vendmit te OSHP-se te datës 11.10.2022, me nr. 397-409/22, për anulim te procedurës ne kundershitim me nenin 62, te LPP-se, shqiptimi i gjobes ndaj AK-se, dhe iniciimi për recokim te certifikates ndaj zyrtarit përgjegjës te prokurimit, perkateissht vendmi i KRPP-se, me nr. 67/2022, i datës 30.12.2022, anulimi i certifikates

Te gjitha faktet e sipër prezantuara, tregojne shkelje ligjore, favorizim përkatësisht diskriminim te kompanis sonë, prandaj kërkojmë qe OSHP, dhe zyrtaret përgjegjës te saje te autorizojne ekspert shqyrtues, profesional, te pa aneshem i cili bazuar ne dispozitat e nenitn 113 dhe 114, te LPP-se i trajton drejte dispozitat ligjore ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerre këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohet**, e bazuar ankesa e OE “Smart Ing Group” shpk,
- II. **Anulohet**, njoftimi i datës 20.06.2025, formulari B58, propozimi për anulimin e aktiviteitit te prokurimit dhe lënda kthehet ne **Ri-vlereim**.
- III. **Kualifikohet**, si e pergjegjeshme oferta e OE ankues “Smart Ing Group shpk
- IV. **Lejohet**, kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses.

Ne si kompani me doemos do ti ndermarrim edhe veprimet tjera ligjore pasi qe haptazi AK, ka ndermarr veprime kundërligjore dhe ka ememinuar kompanin tone kunderligjeshem.

Se bashku me këtë kerkese bashkangjitur gjeni vemdmimin e OSHP-se, KRPP-se dhe provat tjera – sqarimi i ofruar ndaj pajisjes se kontestuar dhe karakteristikat e pajisjes.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkakttojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*